



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 469/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me apelin Eman Rrahmani, nga Prishtina, kandidat për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.469/2019 e datës 08.11.2019, e paraqitur nga Eman Rrahmani nga Prishtina kandidat për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, për shkak të mospërputhjes së rezultateve.

A r s y e t i m

Me datë 08.11.2019, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Eman Rrahmani ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.469/2019, me të cilën kërkon që në këto vendvotime: 1919X/02R, 1915E/02R, 1906E/03R, 1906/05R, 1922E/01R, 1924E/04D, 1943E/01D, 1958E/01D, 1901E/02R, 1902E/01R, 1902E/08R, 1904E/08R, 1904E/14R, 1906E/10R, 1906E/23R, 1915E/07R, 1916E/04D, 1919X/04R, 1927E/09D, 1936E/01D, të bëhet përmirësimi i rezultateve sipas FRP, për shkak se pretendon se në këto vendvotime ka pasur gabime teknike.

Në përgjigje në ankesë të datës 09.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se, ankuesi Eman Rrahmani, nga subjekti politik “LVV” i cili pretendon se në vendvotimin 1919x/02R, është e pakuptueshme se në FRK ka shumë përmirësime të votave të paraqitura, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj ju njofton, si në vijim:

Në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përpunohen votat e subjekteve me votat e Kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka

vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim. Auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të të gjeturave përgatit raportin dhe QNR në bazë të raportit të Auditimit rekomandon KQZ-në që vendotimet që kanë probleme të kësaj natyre të Rinumërohen.

Pra asnjë Formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti do ti nënshtrohet Auditimit në QNR, metutje theksojn se i gjithë dokumentacioni mund të ju ofrohet për hetim, verifikim dhe konstatim të gjendjes faktike për PZAP dhe organet e drejtësisë.

Pala ankuese nuk ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk ka prezentuar mjaftueshëm prova për rastin konkret.

Andaj, bazuar në nenin 5 paragrafi 7 i Rregullës së PZAP-së nr. 02/2015, dhe arsyet e lartëcekura, konsiderojmë se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e tij parashtruesi nuk i ka mbështetur në asnjë provë materiale por vetëm dyshon në parregullsi, që vlerësohen si pretendime të supozura, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj faktin se ka pasur gabime gjatë rezultateve të publikuara në FRP në vendotimet e lartëcekura, ashtu siç pretendohet në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Eman Rrahmani i subjektit politik LVV, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3 të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë gabim dhe mospërputhje të rezultateve.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.469/2019 më datën 09.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.